



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Rexhepi Zeqiri Zejna LLC" të datës 06.10.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbimet e përfaqësimit të avokaturës dhe procedurave të ndërmjetësimit" me nr. të prokurimit 616-25-8826-2-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Rexhepi Zeqiri Zejna LLC" të datës 06.10.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbimet e përfaqësimit të avokaturës dhe procedurave të ndërmjetësimit" me nr. të prokurimit 616-25-8826-2-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Rexhepi Zeqiri Zejna LLC" (tutje "parashtruesi") me datë 06.10.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbimet e përfaqësimit të avokaturës dhe procedurave të ndërmjetësimit" me nr. të prokurimit 616-25-8826-2-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

P.1. - "kërkesat për referenca në fushën e arbitrazhit në kundërshtim me shërbimet e kërkuara në paramasë";

- Lidhur me këtë pretendim ankimor, në konsultim edhe me njësinë kërkuese, është konstatuar se kërkesa për referencë në fushën e arbitrazhit është absolutisht e domosdoshme për faktin që Komuna e Prishtinës vazhdimisht ballafaqohet me nevojën për përfaqësim në procedura të arbitrazhit. Në fakt këtë kërkesë nuk e ka kundërshtuar as vet parashtuesi pasi që ai nuk ka kërkuar që kjo kërkesë të largohet por vetëm ka theksuar që kërkesa nuk është e përcaktuar në paramasë. Lidhur me këtë pikë të pretendimit duhet sqaruar se kërkesat e DT nuk përcaktohet në paramasë por në FDT ndërsa paramasa është në përputhje të plotë edhe rregulloren për tarifin e Odës së Avokatëve të Kosovës të vitit 2017 e cila ndër të tjera rregullon edhe këtë çështje.

P.2. - "kërkesa që shoqëria e avokatëve të jetë e regjistruar para së paku shtatë viteve është diskriminuese";

- Komuna e Prishtinës ka me qindra raste aktive në gjykatë dhe në çdo vit deklaron me miliona euro detyrime kontigjente për shkak të këtyre rasteve gjyqësore. Për këtë arsye është e domosdoshme që shoqëria e avokatëve të ketë përvojë të mjaftueshme profesionale për të ofruar shërbimet ligjore në mënyrë efikase, efektive dhe profesionale për Komunën e Prishtinës. Megjithatë për t'u siguruar që kjo kërkesë nuk është diskriminuese, nuk është kërkuar që shoqëria të ketë 10 vite përvojë mirëpo janë kërkuar vetëm 7 vite përvojë për t'u siguruar që kërkesa nuk është aspak diskriminuese.

P.3. - "në paramasë mungon tarifimi për shërbimet e opinioneve ligjore".

- Vlen përshtatshmërisht përgjigja e ofruar në P.1.

Përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësi kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësi kërkuese.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtuesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtuesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi

Prishtinë, 17.10.2025


Visar SHEHU
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.